BASHKIA PUSTEC

QARKU KORCE

PLANI MENAXHIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE BASHKIA PUSTEC

Afati i përdorimit 2025- 2035



BASHKIA PUSTEC

PLANI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE TË BASHKISË PUSEC

KONCEPTOI

Ing. Kristaq Shore

MIRATOHET:

Me Vendimin NR 69 Date 29.06.2025 nga komisioni i miratimit të planit të Menaxhimit të pyjeve bashkiake (Bashkia Pustec) ngritur për këtë qëllim nga ana e bashkisë Pustec.

KRYETARI I BASHKISE

Pali KOLEFSKI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA PUSTEC

Pustec Gusht 2025

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I PARË.....3
ASPEKTE TË PËRGJITHSHME
1.BASHKIA PUSTEC SI PJESË E PARKUT KOMBËTAR TË PRESPES.....4
1.2.Baza Ligjore.....4
1.3. Qellimi i Planit te Menaxhimit.....5
KAPITULLI II.....5

2.PJESMARRJA E KOMUNITETIT LOKAL DHE.....6
ANALIZA SOCIAL EKONOMIKE E BASHKISË.....6
2.1-2.1.2.Pjesmarrja dhe zbatimi nga popullatat lokale
2.1.1.Të dhënat dhe informacioni
2.1.2.Të dhëna dhe informacione social ekonomike .6
2.1.3.Ndarja në parcela/nënparcela në nivel Bashkiak
2.1.4.Të dhëna mbi funksionet aktuale tëPyjeve e Kullotave
2.1.5. Analiza social ekonomike
2.1.6.Të dhënat demografike
2.1.7. Përdorimi i tokës bujqësore
2.1.8. Tokat e abandonuara
2.1.9. Të dhënat mbi blegtorinë
2.2.LIVADHET SUB-ALPINE MALORE
2.2.1. Prodhimet pyjore që përdoren zakonisht
2.2.2 Drutë e zjarrit
2.2.3. Probleme të kullotjes
2.2.4. Aspekte te tjera te perdorimit te prodhimeve te pyjeve dhe kullotave
2.2.5.Masat e propozuara për menaxhim,
KAPITULLI III. MJEDISI EKOLOGJIK.....11
3. Pyjet dhe kullotat e bashkisë në kontekstin e Parkut kombëtar të Prespë
3.1. Kushtet stacionale 11
3.1.1-3.1.5. Pozicioni gjeografik, kufizimet, Klima, Relievi, Perberja e siperfaqes shtrese
Veprimtaria ekonomike e banoreve te komunes 12
3.1.6-3.1.7. Morfologjia e territorit, Tipi I tokes.....13
3.1.8.-3.2.1. Hidrografia Fenomeni i erozionit, Rrjeti rrugor, Përdorimi i territorit 14
3.2.2-3.2.4.Pyjet, Shkurret, Cungishtet, Trungishte, Kullotat, Tokat djerrë,
Pyllëzimet, Vegjetacioni dhe biodiversiteti.....15
3.2.7. -3.3.3. Tipet aktuale të Pyjeve dhe potenciali natyror, Origjina e pyllit dhe natyraliteti,
Biotopet e vecantë, Formacionet pyjore dhe bashkëshoqërimet, Bimët endemike, Llojet e rrezikuara
Rezervat gjenetike, ...16
3.3.4.-3.3.5. Zonat e mbrojtura, Llojet kryesore të faunës së egër 17
KAPITULLI IV.....17
ANALIZA E PYLLIT.....17
4.-4.1.3 Prodhimet pyjore, Prodhimet drusore dhe cilesia,
Prodhimet pyjore jo drusore, bimet mjeksore, Funksionet kryesore ,
Nënzonëa e Përdorimit Tradicional dhe të Qëndrueshëm (ZPTQ).....18
4.1.4. Dëmtimet/rreziqet e shkaktuara nga zjarri, orteqet, insektet.....19
4.1.5.-4.1.6. Sistemet aktuale dhe të mëparshme të menaxhimit të pyjeve
Tipet e grumbullit.....20

4.1.7.-4.2.2 Metodologjia e vëzhgimeve biometrike,
Metodologjia e përdorur për grumbullimin e të dhënave,
Specifikimet për sipërfaqet provë të përhershme,
Prodhimtaria, Klasat e moshës 21
4.2.3.-4.2.7. Tipet strukturore dhe faza e zhvillimit, Llojet pyjore,
Volumi dhe rritja , Prerja e lejuar vjetore, Rigjenerimi natyral/artificial,.....22
4.2.8.-4.2.9. Ndryshimet nga plani i mëparshëm i menaxhimit, Bimësia barishtore.....24
KAPITULLI V OBJEKTIVAT AFAT GJATE DHE AFAT SHKURTER.....24
5.1.-5.1.2. Prodhimet drusore lidhur me mundesine vjetore te ndërhyrjes,
Prodhimet pyjore jo drusore, bimët mjeksore, Funksionet kryesore 24
5.1.3.-5.2. Menaxhimi i rreziqeve, Sistemet e menxhimit të pyjeve, Tipet e pyllit,
Të dhënat biometrike, Klasat e moshes, Llojet Pyjore, Pyllëzimi/ripyllezimi ,
sistemimet malore ndërtim lerash, Qëndrueshmëria e mjedisit.....25
KAPITULLI VI PLANIFIKIMI I MASAVE.....26
6.-6.1.4. Pyllëzimet, Pyllëzimet për sekuestrim karboni, Masat në trungishte,
Shfrytëzimet, Pyllëzime në shkurre dhe toka aluvionale, Masat në Cungishte/shkurre,.....26
6.1.5.-6.1.9. Masa për luftimin e erozionit, Masa për kontrollin e erozionit,
Problemet e ndërhyrjes, Ndikimi ndaj mjedisit.....27
KAPITULLI VII KULLOTAT..... 28
7.1.-7.1.1.Të dhëna të përgjithshme mbi sipërfaqen gjeomorfologjike,Tipi i kullotave.....28
7.1.2.-7.1.3. Percaktimi i biomases, Përmirësimi i kullotave dhe Plani I ndërtimit të lerave 29
7.1.4.Objektivat e Menaxhimit për Kullotat.....30
KAPITULLI VIII ANALIZA EKONOMIKE.....30
Preventivat 31-48
KAPITULLI IX ASPEKTE SOCIALE DHE ORGANIZATIVE.....49
KAPITULLI X ANEKSE TE PLANIT TE MENAXHIMIT.....50

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

1.Hyrje.

1.1.BASHKIA PUSTEC SI PJESË E PARKUT KOMBËTAR TË PRESPËS

Bashkia Pustec ndodhet në skajin verilindor të qarkut të Korçës, shtrihet në pellgun ujëmbledhës të liqenit të Prespës dhe kufizohet:

a) Veri: Kufiri shtetëror me Maqedoninë e veriut(Parkun Kombëtar të Galicicës).

b) Lindje: Kufijtë shtetërorë me Maqedoninë e veriut dhe Greqinë, pikërisht në kufirin ujor ndërshtetëror në Liqenin e Prespës së Madhe.

c) Jug: Kufiri shtetëror me Greqinë; Mali i Ivanit (1,768 m) dhe Qafa e Zvezdës (1,099 m).

d) Perëndim: Kufiri administrativ i Bashkisë në Qafa e Zvezdës (1,099 m), e cila vazhdon me kufirin e zones të mbrojtur ''Peizazhin e Mbrojtur Ujor Tokësor të Pogradecit'' (1,912 m), Maja e Zonjës (2,288 m) dhe në vazhdim me kufirin shtetëror të Maqedonisë.

I gjithë teritori i bashkisë Pustec shtrihet në Parkun Kombëtar të Prespës i cili ka një sipërfaqe prej 27,613.05 ha. Vendimi për krijimin e parkut është marrë më 18.2.1999 dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare ndërsa është përuruar zyrtarisht në Shkurt 2000, rishikuar me VKM nr 59 dt 26.01.2022

Qendra e Bashkisë Pustec ndodhet 25 km larg qytetit të Korçës. Ajo përbëhet nga 9 (nëntë) fshatra dhe ka një shtrirje prej 45 km nga fshati Gorica e Madhe deri në Cerje. Liqeni i Prespës së Madhe ka një sipërfaqe 253.6 km2 prej së cilës rreth 48 km2 i përket pjesës shqiptare. Lartësia mbi nivelin e detit e pasqyrës së ujit aktualisht (regjistrimi I dt.30.04.2025) është 842 m. Pika më e lartë është "Pllaja e Pusit" në Malit të Thatë me 2.288 m mbi nivelin e detit

Kërcënimi më i madh në periudhën e krijimit të Parkut Kombëtar ishte mbishfrytëzimit i pyjeve nga ish Ndermarja e Shfrytëzimit të Pyjeve Korçë, kondrabanda e shfrenuar e druve të zjarrit e viteve 90-të e cila u përjetua nga ekosistemet pyjore deri në vitin 2012 nga njerëzit brenda dhe jashtë Parkut. Nevojat jetike për dru zjarri dhe prodhimi i tyre pa kriter ka dëmtuar pyjet dhe ka krijuar formacione pyjore të ngjashme me shkurret.

Mbikullotja dhe kullotja pa kriter nga blegtoria, zjarret e qëllimshme në kullotat nga vetë barinjtë përfitues, kanë çuar në degradim edhe ekosistemet kullosore. Pas krijimit të Parkut Kombëtar të Prespës shumë nga faktorët kërcënues të përkeqësimit të ekosistemeve janë reduktuar dhe pyjet kanë mundësinë për t'u rimëkëmbur, çka tashmë është e dukëshme.

Megjithatë, të gjitha kërcënimet ende nuk janë zgjidhur. Popullsia, njerëzit brenda parkut kombëtar kanë nevojë për sigurimin e druve të zjarrit për të përballuar kushtet e vështira të dimrit. Përdorimi i sistemeve më efikase për ngrohjen në banesa, termoizolimi i shtëpive dhe përdorimi i burimeve alternative të energjisë,ndihmojë për të kapërcyer këtë kërcënim të pranishëm në park.

Duke qënë se teritori I Bashkisë Pustec përkon me pjesen më të madhe të Parkun Kombëtar të Prespës , kjo përbën nje vlerë të shtuar për këtë Bashki në ndërtimin e një marrëdhënie harmonike mes komunitetit dhe Parkut, si dhe integrimin në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.

POZICIONI GJEOGRAFIK I SHTRIRJES SË BASHKISË PUSTEC



1.2.Baza Ligjore

Hartimi i Planit te ri të Menaxhimit per Pyjet dhe Kullotat e bashkisë Pustec, e bazohet në : Ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*"I ndryshuar datë 17.12.2015 neni 8,9, nënpika 1.1, gërma(b), neni 55, pika 2 dhe 6, neni 64 "*Kompetenca dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë" pika(c);*Ligjit nr. 57/2020 "*Për Pyjet;* " Ligjit nr 107/2014 datë 31.7.2014 "*Për planifikimin dhe dhe zhvillimin e teritorit*"; Ligjit nr.115/2014 datë 31.7.2014"*Për ndarjen administrativo-teritoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*"; Vendimi I Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike...*"I ndryshuar me VKM nr.398 datë 13.5.2020 "*Për disa ndryshime në vendimin nr433, datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave* ", Manualit të Planeve të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave Janar 2019

1.3. Qellimi i Planit te Menaxhimit.

Prezantimi i objektivave te projektit dhe te planit te menaxhimit tek te gjithe aktoret ne baze Bashkie.

Projekti ka për qëllim vlerësimin, ruajtjen e bimesise ekzistuese dhe e ekosistemit ne pergjithesi nepermjet sensibilizimit te opinionit publik, zbatimit te nje plani investimesh, per zhvillimin e qendrueshem te pyjeve e kullotave dhe plotesimit te nevojave te fshataresise per dru zjarri e baze ushqimore per blegtorine.

Ky plan synon të ruajtur larminë biologjike dhe për të mbrojtur ekosistemet e përfshira në të për të ruajtur funksionet dhe shërbimet e tyre për popullsinë aktuale dhe për brezat e ardhshëm.

.Plani I Menaxhimit do të perfshije shume aspekte te mbrojtjes se mjedisit pasi gjithe territori i bashkisë eshte pjese integrale e parkut kombetar te Prespes, mirëmenaxhim te pyjeve/kullotave dhe eshte nje mundesi per banoret dhe Bashkinë Pustec per te terhequr edhe donatore te tjere te interesuar per kryerjen e studimeve dhe zhvillimin e projekteve në ekosistemet pyjore/kullosore dhe mbrojtjen e mjedisit në tërësi.

Rritjen e kapaciteteve te bashkisë dhe komunitetit per administrimin e pyjeve dhe kullotave bashkiake.

KAPITULLI II

2.PJESMARRJA E KOMUNITETIT LOKAL DHE ANALIZA SOCIO- EKONOMIKE E BASHKISË PUSTEC

2.1.Pjesmarrja dhe zbatimi nga popullatat lokale i praktikave tradicionale të administrimit të pyjeve me mbështjetje ose në partneritet me AdZM Korçë përbën kushtin kryesor. Pjesmarrja dhe bashkëmenaxhimi vendos një hap të rëndësishëm për resurset natyrore, pasi sipërfaqet pyjore dhe kullosore bashkiake integrohen dhe menaxhohen njesoj si ato të "Parkut Kombetar të Prespës".

Gjate hartimit te Planit të ri të Menaxhimit së bashku me përfaqësues të komunitetit lokal, do të identifikohen dhe vlerësohen sipërfaqet pyjore/kullosore për të identifikuar, për të përcaktuar dhe planifikuar mënyrën e përdorimit, gjendjen aktuale e për ta analizuar atë në bashkëveprim me përdoruesit. Të gjitha këto bene që popullatat lokale të jenë të interesuara për të marrë pjesë në rishikimin e planit të mbarështimit dhe në zbatimin korrekt të objektivave që vendosen për përmirësimin e situatës aktuale.

Në takimin e organizuar në Bashkinë Pustec mbas diskutimeve informuese, të hapura, dhe te fokusuara ne interesat e komunitetit dolën për zgjidhje problematikat e poshtëcituara:

* Detajimi i problemeve aktuale te komunitetit rezident në lidhje me ekosistemet pyjore dhe ato kullosore

*Hapat dhe metodologjia e ndjekur për hartimin e Planit te Menaxhimit te Pyjeve dhe Kullotave me pjesmarrjen e grupeve të interesit

*Bashkëpunim me Shoqatën e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave, AdZM Korçë dhe bashkinë Pustec

* Prezantimi i objektivave dhe aktiviteteve të Planit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave.

*Grumbullimi i informacionit të përgjithshëm për bashkinë.

2.1.1.Të dhënat dhe informacioni u fokusuan në:

a- Pozicioni gjeografik, relievi dhe infrastruktura rrugore,

b- Popullsia, përbërja e saj, punësimi dhe lëvizja demografike,

c- Toka bujqësore dhe zhvillimi i bujqësisë, raportet e tyre në lidhje me pyjet dhe kullotat.

d- Blegtoria, numuri, llojet me te preferuara, baza ushqimore duke perfshire dhe ceshtjen e kullotjes

e- Burimet natyore me fokus të vecantë pyjet dhe kullotat e fshatit, traditat në menaxhim dhe përdorimin e tyre.

Përsa më sipër u bë krahasimi me të dhënat e grumbulluara, nivelin e zhvillimit dhe menaxhimit të burimeve natyrore, duke nxjerrë konkluzione të rëndësishme. Bazuar në këto të dhëna, të cilat janë vlerësuese në hartimin e raportit final për Bashkinë Pustec.

2.1.2.Të dhëna dhe informacione social ekonomike

Të dhënat social ekonomike të grumbulluara per teritorin Bashkiak do të pasqyrohen në PM ne formen e nje raporti të shkruar.

Ekipi i mbarështrimit filloi punën në terren për të identifikuar pjesët e pyllit e kullotës bashkiake bazuar në ndarjen parcelare.

2.1.3.Ndarja në parcela/nënparcela në nivel Bashkiak

Për procesin e ndarjes parcelare u zbatua ndarja e planit të vjeter të mbareshtrimit i hartuar ne vitin 2009, me qëllim të mbajtjes së kadastrës pyjore

Skeda e përshkrimit parcelar në terren përmban të dhëna identifikuese të parcelës si vijon:

Përshkrimi i territorit, përdorimi i territorit dhe përshkrimi i pyllit, forma e qeverisjes, tipi i pyllit, prodhimet jo drusore, rreziqet, biotopet e vecantë, të dhënat dendrometrike për shtresat, metoda e vlerësimit, sipërfaqet provë të përherëshme, kati, lloji, mosha, lartësia, diametri, kurorëdendësia, fazat e zhvillimit, rritja vjetore dhe volumin, funksioni aktual dhe i propozuar.

Kjo menyrë e identifikimit dhe e rregjistrimit të problemeve krijoi një bazë ku të gjithë anëtarët e komunitetit mund të kontribuojnë me mendimet e tyre dhe duke i afruar ata gjithnjë e më afër në ndjenjën që kjo i shërbën dhe është pasuri që i takon vëtë përdoruesve.

2.1.4.Të dhëna mbi funksionet aktuale tëPyjeve e Kullotave sipas përdorimit dhe qëllimit.

Bashkia Pustec ka një sipërfaqe totale si më poshtë:

a- Pyjet (shkurre)31.8 ha,

b- Kullotat 261 ha,

c- Sip. Jo produktive 0 ha,

d- Toka bujqësore 1284 ha.

2.1.2.Analiza në nivel grumbulli tregon shtrirjen e meposhteme:

a- Trungishtet zenë 0 ha, ose 0 %

b- Cungishtet zenë 0 ha,

c- Shkurret zenë 31.8 ha,

Kjo tregon se sipërfaqja pyjore e **Bashkisë Pustec** *(forma e qeverimit)* është shkurre.

2.1.5. Analiza social ekonomike

Bashkia Pustec drejtohet nga Kryetari i Bashkisë dhe Keshilli Bashkiak, që përbëjnë organet e pushtetit lokal dhe zgjidhen me zgjedhje të përgjithëshme njëhere në katër vjet.

Me problemet e bujqesisë, mjedisit, tokave bujqësore merret seksioni i shërbimeve bujqësore, i cili luan edhe rolin e shërbimit të ekstensionit

Fshatrat drejtohet nga kryesia e fshatit dhe kryetari, qe zgjidhet me votim të hapur në mbledhje të të gjithe fshatit. Në përgjithësi këshillat janë organizuar mirë dhe përpiqen në zgjidhjen e problemeve dhe halleve të komunitetit .

Politika e zhvillimit : Bashkia Pustec ka një pozicion gjeografik shume te pershtatshem dhe ka shume mundesi per zhvillimin e turizimit, si rrjedhoje e pejsazhit, klimës, ajrit, dhe vlerave kurative e estetike. Bashkia ndodhet në pikën lidhese te Shqiperise me Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, gjë që krijon premisa dhe mundësi punësimi sezonal në shtetet fqinjë. Prania e Liqenit të Prespës, shton së tepërmi bukurinë dhe vlerat e kësaj zonë si premisa mjaft të rëndësisshme për zhvillimin e turizmit dhe të bashkisë në përgjithësi. Gjithë territori i bashkiak është pjesë e parkut kombëtar të Prespës.

2.1.6.Të dhënat demografike

Baskia Pustec popullohet nga 1330 familje me 4627 banore dhe përbëhet nga 9 fshatra:

Kallamas, Goricë e Madhe, Goricë e Vogël, Gollomboc, Liqenas, Diellas, Lajthizë, Zaroshkë, Cerje,

Mosha mesatare është45 vjec. Ndarja e punëve familjare është për gratë kujdesimi brënda shtëpisë për fëmijët, gatimin, punë në bujqësi dhe kujdesin për blegtorinë. Burrat pothuajse kanë emigruar duke punuar kryesisht në Maqedoninë e veriut dhe Greqi. Pjesa e mbetur e popullsisë janë kryesisht të moshuar merret me bujqësi, kullotjen e bagetive, tregëtinë e prodhimeve bujqesore e blektorale dhe peshkut që sigurohet në liqenin e Prespës. Raporti femra e meshkuj pothuaj është i barabartë.

Punësimi në këtë zonë është kryesisht emigimi i përkohëshëm dhe në sektorin privat e familjar. Emigracioni në vëndet fqinj është i lartë sidomos për moshat e reja, që sigurojnë të ardhura për familjet e tyre, por që kanë zhvilluar dhe zonën duke investuar në ndërtimin e shtëpive të reja, si dhe në rritjen e mirqënies të familjeve të tyre.

Tabela Nr.1.Të dhenat demografike

Nr	Fshati	Numri i familjeve	Numuri banorëve	Femra	Meshkuj	Tëaftë për pune	Tokë bujqësore ha
1	Kallamas	201	745	327	418	432	185
2	Gorice e Madhe	144	555	255	300	344	214
3	Goricë e Vogël	105	412	212	200	240	67
4	Gollombo c	81	295	135	160	180	88
5	Djellas	153	566	294	272	362	142
6	Liqenas	390	1166	595	571	781	231
7	Lajthizë	67	258	134	124	181	72
8	Zaroshkë	114	384	196	188	261	107
9	Cerje	75	246	123	123	172	178
Bashkia		1330	4627	2261	2366	2953	1284

2.1.7. Përdorimi i tokës bujqësore

Ç'do familje ka mesatarisht 0.95 ha tokë bujqësore, që është privatizuar pas vitit 1991 në bazë të ligjit Nr.7501 për ndarjen e tokës bujqësore.

Toka bujqësore mbillet pjesërisht me grurë, miser, fasule, perime, patate, jonxhe për blegtorinë dhe punohet në shumicën e sipërfaqes me mjete të mekanizuara, ndërsa një pjesë e vogël me mjete të thjeshta. Prodhimet bujqësore kanë rendimente të ulta, kjo pasi në të gjithë fshatrat mungon rrjeti ujitës Vaditja përdoret vetëm për perimet që zakonisht mbillen buzë liqenit të Prespës dhe uji merret përmes elekropompave të vogla. Rehabilitimi i sistemit të ujitjes kërkon investime për ta rivenë në punë dhe mirëmbajtur dhe për konkluzion, bëhen faktor serioz kufizues në rendimentet e kulturave bujqësore. Mungesa totale e ujitjes bën që prodhimet bujqësore nuk i plotësojne nevojat e banorëve me drithëra buke, ndërsa me perime e zarzavatet pothuaj i plotesojnë nevojat për çdo familje, por nuk bëhet fjalë për tregtimin e tyre dhe sigurimin e të ardhurave, por një e ardhur për rritjen e mirëqënies familjare, sigurohet nga blegtoria, nëpërmjet shitjes së saj për prodhim mishi.

2.1.8. Tokat e abandonuara.

Ne territorin e bashkisë Pustec ka një sipërfaqe tokash të abandonuara prej rreth 87 ha, të cilët kanë ardhur si rezultat i refuzimit ose paleverdishmerisë për ti mbjellë ato nga banorët vëndas. Aktualisht kjo sipërfaqe përdoret si livadhe dhe kullotë nga banorët vëndas. Këto toka kryesisht janë si rezultat i shpyllëzimeve të sipërfaqeve pyjore të ciat janë kryesisht toka të varfëra dhe në terrene të pjerrta.

2.1.9. Të dhënat mbi blegtorinë dhe mënyrat e sigurimit të bazës ushqimore

Ne bashkinë Pustec mbarështohen rreth 600 lope, 400 dhi, 1300 dele. Gjithashtu shumë familje mbarështron dhe kafshë pune si kuaj, mushka dhe gomerë, që rregjistrohen rreth 350 krere.

Pamvarësisht rënies drastike të numurit të blegtorisë, kryesisht të dhisë, aktualisht praktikohet mbarështrimi i bagëtive në shtëpi duke ushtruar kullotjen kolektive kryesisht për lopën, ndërsa dhia mbarështrohet duke ngritur tufa nga disa familje(Shulin, Pustec), aktivitet që zhvillohet si biznes familjar I regjistruar me NIPT fermeri pranë drejtorisë së Bujqesisë Korçë. Akoma nuk praktikohet mbarështrimi me stan ose shtegtimi i blegtorisë. Në periudhën e dimërit bagëtitë mbahen në zona të ulëta afër qendrave të banuara të ose në rastin e ditëve me dëborë ato mbahen për disa ditë në rregjim stallor.

Si bazë ushqimore aktualisht përdoret në sasira të vogla gjethi i dushkut dhe gjërësisht foragjere, tagji dhe kullotja në pyje dhe tokat e abandonuara.

2.2.LIVADHET SUB-ALPINE MALORE

Shumica e zonave mbi lartësinë 1.650 m m.n.d. janë të mbuluara nga livadhet malore sub-alpine. Vetëm në disa pika gjenden pyje ahu dhe drurë të rinj rrobulli (*Pinus heldreichii*) të cilat aktualisht përfaqësohen vetëm nga disa individë në lartësitë deri në 1.990 metra m.n.d. Në këtë kontekst, zjarret në kullota, qofshin këto natyrore apo njerëzore, luajnë një rol vendimtar në ruajtjen e kullotave subalpine nga ekspansioni i pyllit. Në malin e thate, në verën e vitit 2024, në të dy anët e kufirit shqiptaro-maqedonas ra një zjarr i madh, i cili dogji pothuajse të gjitha shkurret me dëllinja duke lënë aty vetëm barin dhe disa bime barishtore. Shkurret e djegura kishin një moshë mbi 40 vjet, çka tregon se edhe zjarret e rëna shumë rrallë luajnë një rol thelbësor në ruajtjen e kullotave alpine nga ekspansioni i pyllit. Vegjetacioni bimor, në ndryshime nga shkurret e dëllinjës, nuk preket nga zjarret dhe madje është kjo bimësi pushton edhe sipërfaqet e djegura.

2.2.1. Prodhimet pyjore që përdoren zakonisht

Brenda zonës së Parkut Kombëtar mbrojtja e natyrës ka prioritet mbi çdo shfrytëzim ekonomik të pyllit
Ndër prodhimet pyjore qëpërdoren nga fshatarësia e kësaj Bashkie, janë ato drusore (dru zjarri, lëndë ndërtimi, gjeth dushku), prodhohet gjithashtu, hunj për gardhe, perimore etj.

2.2.2 Drutë e zjarrit.

Bashkia Pustec ka një sipërfaqe të vogël Pylli prej 31.8ha, kryesisht shkurre, e cila është e degraduar në maksimum, qoftë nga banorët vëndas ashtu edhe nga mbikullotja. Furnizimi me dru zjarri nga bashkia Pustec është i pamundur prandaj plotësimi I nevojave të komunitetit resident realizohet nga pyjet shtetërore, që aktualisht janë pjesë e parkut kombetar të Prespës.

Menaxhimi i pyjeve të ulët (cungishtave) lejon një furnizim të qëndrueshëm të popullatës lokale me dru zjarri e cila është thelbësore pasi nuk ka në dispozicion burime alternative të energjisë.

Një nga karakteristikat e cungishtave është fakti se në të gjithë zonat e mëdha pyjore ripërtëritja sigurohet në rrugë vegjetative, për shkak të ndërhyrjeve të njeriut. Prerjet janë kryer disa herë brenda pak viteve. Drurët nuk janë në gjëndje për të prodhuar fara për shkak se ata janë në moshë shumë të re.
Bashkia Pustec nëpërmjet këshillave të fshatrave dhe SHPPK të bëjë dhe koordinojnë prodhimin e druve të zjarrit sipas fshatrave në përputhje me mundësinë e prodhimit të çdo parcele dhe njëkohësisht të frenohet nga vet komuniteti në bashkëpunim me AdZM Korçë. Procesi I sigurimit të nevojave të komunitetit me dru zjarri në zbatim të Planit të menaxhit të PKPrespa dhe me mbështetjen e Zonave të Mbrojtura ka qënë I suksesshëm.
Hartimi I planit të ri të menaxhimit për PKPrespa do të garantojë plotësimin e nevojave për material ngrohës dhe burime të tjera natyrore.

2.2.3. Probleme të kullotjes

E ardhmja e pyjeve varet shumë nga disiplinimi i kullotjes duke respektuar ndalimin e kullotes nga 3-5 vjet, në parcelat me riperteritje natyrale. Karakteristikë në Bashkinë Pustec është kullotja e gjedhit në pyll, kjo për shkak të

prodhimtarisë shumë të ulët të tokave bujqësore. Tradita e fundit në këtë Bashki është që si bagëtitë e imta dhe gjethi grumbullohen në tufa dhe ato kulloten çdo ditë në pyll ose kullotë (kryesishtne sezonin e verës). Përveç kullotjes së lirë në natyrë, banorët sigurojnë dhe bazën ushqimore në pyje e kullota (gjeth dhe bar i thatë) gjë që bën që pyjet dhe kullotat të sigurojnë rreth 80-90% të nejove ushqimore për blegtorinë. Ky raport në disfavor te pyjeve duhet të përmirësohet në mënyrë urgjente duke rritur prodhimtarinë e foragjereve në tokat bujqësore . Për këtë problem mjaft të rëndësishëm është diskutuar me strukturat lokale dhe Bashkinë që të vendos ne prioritetet e saj të zhvillimit. Kjo masë jo vetëm do të ulte presionin ndaj pyjeve duke sjellë përmirësimin e tyre, por do të kishte një ndikim shumë të madh në përmirësimin e vlerave mjedisore dhe pejsazhistike të zonës në kuadrin e parkut të Prespës, duke sjellë nxitjen e zhvillimit të turizmit në zone.

2.2.4. Aspekte te tjera te perdorimit te prodhimeve te pyjeve dhe kullotave

Ne Bashkine Pustec prodhimet pyjore dhe kullotat perdoren nga fshataresia kryesisht per nevojat e tyre per dru zjarri dhe kullote per blegtorine, ndersa prodhime te tjera si per qymyr etj, nuk aplikohen. Nga kullotat sic u permend me lart prodhohet mase e thate per blegtorine.

2.2.5.Masat e propozuara për menaxhim,

Përshkrimit parcelar është pjesa më e rëndësishme e cila pasi kërkon një harmonizim sa më të mirë të masave silvikulturore, metodave të menaxhimit dhe nevojave të përdoruesve duke synuar në krijimin e pyjeve shumë-strukturorë dhe shumë funksional.

Dokumenti bazë që siguroi grupi i punës ishte plani i vjetër i Menaxhimit I vitit 2009 i cili ka qënë funksional pranë Bashkisë Pustec, për periudhën e vlefshmërisë së tij 2009-2019. Po ashtu një bazë e fortë mbështetëse ka qënë Plani I Menaxhimit të PK'Prespa'(2014-2024) si dhe dokumenta, informacione apo studime të tjera që janë bërë deri në periudhën aktuale në PK"Prespa", me mbështetje të donatorëve ndërkombëtar si KFË, PONT, UNDP, apo organizata mjedisore PPNEA, ACEG "Unë Gruaja" etj .

Kufijtë e fondit Pyjor-Kullosor bashkiak, sipas VKM 433 dt 8.06.2016, për arsye të përfshirjes të të gjithë teritorit të Bashkisë Pustec brënda "PKPrespa", jane tkurur, duke rënë nga 4316ha pyje dhe kullota në 490.00ha në Total, ku vetem 31.8 ha janë pyje (shkurre) dhe pjesa tjetër prej 458.20 ha kullotë sub Alpine.

Tabela nr2. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të bashkisë Pustec.

Shtojca 35

Nr.	Qarku	Bashkia	Kodi Kadastral	Ekonomia pyjore kullosore	Ngastra/ nëngastra	Sipërfaqja Ha	Kategoria e përdorimit të teritorit	Shënime
1	Korçë	Pustec	KO0200011	EK Bilisht	11	21.40	Kullotë	x
2	Korçë	Pustec	KO0200012	EK Bilisht	12	164.40	Kullotë	x
3	Korçë	Pustec	KO1200001	EK Mali I Thatë	1	121.40	Kullotë	çezmë
4	Korçë	Pustec	KO1200002	EK Mali I Thatë	2	53.60	Kullotë	x
5	Korçë	Pustec	KO1200005	EK Mali I Thatë	5	71.60	Kullotë	x
6	Korçë	Pustec	KO1200006	EK Mali I Thatë	6	42.60	Kullotë	1 Lerë uji
7	Korçë	Pustec	KO1200007	EK Mali I Thatë	7	52.00	Kullotë	x
8	Korçë	Pustec	KO1200008	EK Mali I Thatë	8	39.70	Kullotë	3 Lera uji
9	Korçë	Pustec	KO1200016	EK Mali I Thatë	16	77.30	Kullotë	x
10	Korçë	Pustec	KO4300134	EP Liqenas	134	31.80	Pyll	x
11	Korçë	Pustec	KO5600136	Qafa e Zvezdës-Trestenik	136	33.00	Pyll	x

Pyje brënda teritorit Administrativ të Bashkisë Pusec……34.80ha.
Kullota brënda teritorit Administrativ të Bashkisë Pusec 458.20ha
Totali Pyje +Kullota..... 490.00ha

Sipas të dhënave të Planit të menaxhimit të PK"Prespa", nga përpunimi me GIS sipërfaqja e ish pyjeve komunalë në Parkun Kombëtar të Prespës është 3,301.345 ha. Pyjet komunalë kanë për qëllim të sigurojnë drutë e zjarrit për popullsinë lokale. Por numri në rritje i banorëve ka bërë që nga këto pyje të pritet një vëllim më i madh druor se sa mundësia që ofrojnë pyjet. Sipas rishikimit të fundit të të ardhurave të komunave nga taksa e pyllit për prodhimin e druve të zjarrit nga pyjet, rezulton se nga komunat përkatëse është grumbulluar taksa vetëm për 895 m^3. Në 12 fshatrat e parkut të ardhurat e përgjithshme të komunave u rritën falë druve të zjarrit. Kjo shumë kap shifrën 278,000 lekë (~ 2,000 €). Pyjet komunale plotësojnë vetëm 5.96 % deri në 6.88 % të nevojave për dru zjarri të popullsisë lokale. Pyjet, në përgjithësi janë në kushte katastrofike dhe për 30 vitet e ardhshme nuk do të jenë në gjendje të përmbushin nevojat e popullsisë lokale për dru zjarri. Objektivi kryesor për menaxhimin e këtyre pyjeve është rimëkëmbja e produktivitetit të tyre me qëllim që të përmbushin kërkesat për energji të brezave të ardhshëm.

KAPITULLI III

MJEDISI EKOLOGJIK

3. Pyjet dhe kullotat e bashkisë në kontekstin e Parkut kombëtar të Prespës.

PKPrespa (bashkia Pustec) megjithëse është një nga Parqet Kombëtar më të rëndësishme të Shqipërisë me potencial të lartë biodiversiteti dhe pejsazh të jashtëzkonshëm ndeshet me probleme të shumta që dëmtojnë dhe varfërojnë biodiversitetin e zonës. Në mënyrë të veçantë janë dëmtuar pyjet, sidomos ato të dushkut. Dushkajat në këtë Park veçanërisht gjatë periudhës 1991-1999 janë dëmtuar rëndë duke u degraduar e shëndruar në formë shkureje si rezultat i prejeve të pa ligjshme, kullotjes së pakontrolluar të dhive dhe krasitjeve pa kriter për gjeth për sigurimin e bazës ushqimore të blegtorisë. Problemi më serioz në pyjet e Prespës është kullotja dhe përdorimi i gjethit të dushkut si bazë ushqimore për blegtorisë. Kjo vjen si pasoje dhe nga fakti se ne këtë zonë familjet preferojnë të mbarështojnë më tepër dhi se sa dhen e lopë. Kullotja e pakontrolluar e dhive dhe krasitja e dushkut për gjeth si rezervë ushqimore dimërore për dhinë ka dëmtuar sipërfaqe të tëra pyjore me dushk shumica e të cilave janë degraduar e kthyer ne forme shkureje duke ulur ndjeshëm vlerat e biodiversitetit dhe ekosistemit të kësaj zone.

Relievi malor ku toka bujqësore është e pakët dhe me prodhimtari të ulët, shkatërrimi i sistemit të ujitjes pas vitit 1990 dhe mungesa e politikave ekonomike për alternativa të tjera zhvillimi e ka lënë këtë zonë në gjëndje të dobët ekonomike. Kjo ka krijuar probleme për zhvillimin ekonomik të zonës, kultivimin e farogjereve dhe pamundësi ekonomike për të blerë ushqim për mbaështrimin e dhënve si kafshë kryesore të blektorisë për ekonominë shtëpiake në vend të dhive. Faktikisht, mbarështrimi i dhisë është më i thjeshtë për banorët e kësaj zone tek të cilët është ngulitur koncepti se dhija është kafsha më e përshtashme për zonën. Kjo sepse dhia përdor si ushqim kryesor gjethet e pyllit për të cilat komuniteti i sheh si mundësinë më të mirë, më të lirë dhe të mundëshme për mbarështrimin e blegtorisë, pamvarëshisht se produktiviteti i dhive është më i ulët se i dhënve. Pra në këtë proces ka ndikuar negativisht prapambetja ekonomike, gjëndja sociale ekonomike e zones, mungesa e zbatimit te ligjit dhe mungesa e plotë e fondeve për përmirësimin e tyre. Kjo situatë ka penguar zhvillimin social ekonomik të zonës si në aspektin e shfrytëzimit në prespektivë të resurseve natyrore ashtu dhe në kuadrin e zhvillimit rural të lidhura me shfrytëzimin e qëndrushmë të burimeve dhe zhvillimin e turizmit. Degradimi i pyjeve të dushkut nuk ka favorizuar zhvillimin e pasurimin e biodiversitetit dhe nuk ka çelur hapësira për zhvillimin e zonës në kuadrin e zhvillimit të qëndrushem.

3.1.Kushtet Stacionale

Kushtet klimatike janë favorizuese për zhvillimin e vegjetacionit pyjor. Bimësia është instaluar në arealin e vet të përhapjes kryesisht zona e dushqeve. Dëbora është faktor kufizues për ndërhyrje gjatë periudhës së dimrit.

Formacionet pyjore në këtë ekonomi janë formuar si rezultat i një bashkëveprimi afatgjatë klimë - vegjetacion. Duke qënë se grumbujt pyjore aktuale janë kryesisht natyrale, rezulton se edhe faktorët pedollogjikë janë mesatarisht të favorshëm për zhvillimin e tyre.

Treguesit e tjere te tokes si thellësia, pjelloria, struktura etj, janë në nivele të ulta dhe të mjaftueshme për tipin e tokave kafe të kuqërremta, që janë tokat karakteristikë në këtë teritor.

Në konkluzion mund të themi se kushtet stacionale (klimatiko - edafike), që prezantohen në këtëzonë, deri diku janë faktor kufizues për zhvillimin e grumbujve pyjore aktuale, gjë që reflektohet në prodhimtarinë dhe në llojshmërinë e tyre.

3.1.1. Pozicioni gjeografik, kufizimet

Bashkia Pustec shtrihet në Lindje të qytetit të Korçës, me distancën 25 km larg tij (qëndra e Bashkisë).

Kufizimi

Veri: Bashkia e Pogradecit (kreshta e Malit te Thatë) dhe Kufiri shtetror me Maqedoninë e veriut

Lindje: Kufiri shtetëror me Maqedoninë e veriut dhe Greqinë

Jug: Kufiri shtetror me Greqinë, NJ.Administrative Progër me këto tregues gjeografik; majat dhe vendet malore Buza e kolicës (2028 m),

Perëndimi : Bashkia Maliq, që kufizohet me kreshtën e Malit të Thatë,

3.1.2. Klima.

Klima përbën një element shumë të rëndësishëm si në formimin e zhvillimin të bimësisë dhe zhvillimin ekonomik të zonës. Në karakteristikat e klimës së krahinës së Prespës, një rol të rëndësishëm luan Liqeni i Prespës , Vargu i malit të Thatë si dhe malet e tjara përreth liqenit. Mund të themi se kjo krahinë shtrihet në zonën klimatike mesdhetare malore,nënzona mesdhetare malore qëndrore.

3.1.3. Relievi kryesisht është malor që gërshetohet me pasqyrën e liqenit të Prespës, ndikimet e tij i jep në qarkullimet malore luginore si dhe në masat ajrore. Rrjedhim i drejtpërdrejtë i relievit janë tërë ato ndryshime që vërehen në vlerat e elementeve metereologjikë, brënda hapsirave të vogla e shumë të vogla (mikroklimat).

3.1.4.Perberja e siperfaqes shtrese dhe bimësia janë faktor që ndikojnë në formimin e klimës. Sipërfaqja shtresë, tokë apo ujë transmeton energjinë në ngrohjen e shtresë së ajrit. Mënyra dhe sasia e transmetimit varet nga karakteristikat fizike të sipërfaqes shtresë. Bimesia eshte faktori klimatik që ndodhet në lidhje të ngushtë e të ndërsjelltë me klimën. Klima luan rolin përcaktues, nga ajo varet zhvillimi dhe përhapja e bimësisë. Vetë mbulesa bimore ka ndikim të jashtëzakonshëm mbi klimën. Në verë, bimësia e mbron tokën nga të nxehtit e diellit. Kështu që temperatura e tokës rezulton më e ulët se ajo e një toke të zhveshur. E kundërta ndodh gjatë natës. Gjithashtu lageshtira e ajrit në viset e veshura me bimësi është më e lartë se në ato të zhveshura

3.1.5.Veprimtaria ekonomike e banoreve te komunes është një faktor shumë i rëndësishëm në krijimin e klimës. Në kushtet aktuale kur ka mungesa si të ujitjes, mekanikës bujqësore, largësisë të tregut për produkte bujqësore, banorët e zonës e kanë mbështetur mbijetesën e tyre tek zhvillimi i belgtorisë.

Diellezimi. Shqipëria dallohet për sasinë e madhe të oreve me diell. Sa për orientim vlerat e sasisë vjetore luhaten nga 2800 orë në ultesiren bregdetare të vendit deri ne 2000 orë në zonat malore.Vlerat më të vogla janë në dhjetor që përkon me zgjatjen e natës. Ky fenomen natyror favorizon komunitetin dhe bashkinë Pustec në përdorimin e energjisë solare si burim energjie dhe ngrohje. Kjo do të çonte edhe në plotësimin e objektivit kryesor që ka patur Plani I Menaxhimit të PKPrespa, uljen e presionit mbi ekosistemet pyjore përmes reduktimin e përdorimit të druve të zjarrit

Temperatura e ajrit. Regjimi termik paraqet ndryshime të shumta që vijnë si rezultat i kushteve të relievit, nga afersia e deteve dhe nga masat ajrore.

Reshjet. Si vecori e përgjithëshme e reshjeve është se ato janë më tepër në shpatet perëndimore e juperëndimore të maleve dhe me pak në shpatet lindore. Një shpërndarje e tille është e lidhur me vendosjen e relievit ndaj trajktoreve të levizjes së cikloneve. Dimri e vjeshta janë të lagët, pranvera e paqëndrueshme dhe vera është e thatë.

Bora. Reshjet në formë bore bien kryesisht gjatë muajve të dimrit. Në fshatrat që ndodhen në lartësi dëbora qëndron per një kohë të gjatë. Vitet e fundit ditët me dëborë pothuajse kanë munguar.

Era Gjatë periudhës së ftohtë të vitit mbizotërojnë era e veriut dhe e verilindjes. Shpejtësia deri 15m/sek, rralle deri 30 m/sek. Kanë karakter luginor malor. Ndërfuten nëpërmjet qafës së Zvezdës dhe luginave të masivit pyjor të Mali Thatë. Erërat perëndimore fryjnë kryesisht në periudhën e verës, kur kontrasti i temperaturës së ujit të detit dhe kontinentit është më i madh.

Fenomeni i thatësirës. Thatësira është e gjatë. Ajo është karakteristikë në periudhën qershor - shtator, por problematike është periudha korrik - gusht.

3.1.6. Morfologjia e territorit

Relievi.

Bashkia Pustec ka një reliev malor i cili është pjesë e bazenit ujembledhës të liqenit të Prespës. Ndikimet e tij ky relief i jep në qarkullimet malore luginore si dhe në masat ajrore. Rrjedhim i drejtperdrejtë i relievit janë tërë ato ndryshime që vërehen në vlerat e elementeve metereologjike, brenda hapesirave të vogla e shumëtë vogla (mikroklimat).

Nga pikpamja gjeografike Bashkia Pustec ndodhet në Krahinen Malore juglindore

Bashkia Pustec ndodhet në pjesën lindore te qarkut të Korçës

Lartësia mbi nivelin e detit

Lartesia minimale mbi nivelin e detit është 842 m (pasqyra e liqenit të Prespës, regjistruar më 31Mars 2025), lartesia maksimale 2287.5 m mbi nivelin e detit (Pllaja e Pusit). Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 1000 m.

Në përgjithësi malet dhe kodrat ngrihen direkt mbi pasqyren e liqenit, por në zonat e fshatrave, Kallamas, Goricë e Vogël, Gollomboc, Liqenas dhe Zaroshkë ndodhen terrene fushore të cilat përbejnë fondin e tokës bujqësore.

Gjeologjia

Ne territorin e komunes mbizoterojne formacionet Gelqerore dhe shume pak formacionet ranore.

Kundrejtimi

Kundrejtimi i përgjithshëm i territorit të bashkisë Pustec është Lindor.

Pjerrësia

Predominon pjerrësia mesatare (10-40%), me një shtrirje në 60% të siperfaqes pyjore si dhe ajo e madhe (41 - 70%) e cila shtrihet ne 20% të sipërfaqes pyjore. Pjerrësia e vogel 0-10% zë rreth 20% të sipërfaqes së përgjithëshme të Bashkisë

3.1.7. Tipi tokes.

Përshkrimi i tokës pyjore. Tipet dhe karakteristikat e tyre

Mbulesa e tokës është e larmishme si nga cilësitë morfologjike ashtu edhe nga ato kimike dhe fizike. Në këtë drejtim rolin kryesor e luajnë relievi, klima, bimësia, përberja e shkëmbit amnor. Çdo kombinim i tyre krijon nëntip toke të veçantë me cilësi të veçanta. Rolin kryesor në procesin pedogjenetik sidomos në qarkullimin e lëndës dhe të energjisë dhe në proceset gjeokimike e gjeofizike e luajnë organizmat e gjallë. Formacioni amnor pa humusin që krijohet nga bimët e mikroorganizmat nuk mund të formojë tokë. Prandaj procesi tokëformues fillon të zhvillohet nga casti i veprimit të organizmave të gjallë mbi shkëmbinjtë mëmë.

Me relievin është i lidhur edhe një tregues i rëndesishme i tokëformimit, sikurse është bilanci ujor i tokës. Zona e Prespës njihet për mungesën e burime të ujit për shkak të formacionit shkëmbor gëlqeror të copëtuar, gjë që bën infilrtimin e shpejtë të ujrave që vijnë nga rreshjet ose të ujrave të liqenit të cilat nëpërmjet kanaleve nëntokësore çojnë ujin e tij në liqenin e Ohrit i cili ndodhet 157m nën nivelin e Prespës. Në këtë rast uji duke kaluar mbi sipërfaqen

e tokës shkakton erodimin dhe varfërimin e tokës në lëndë ushqyese. Kjo vihet re veçanërisht kur toka është e zhveshur nga bimësia, ngacmohet nga faktorë të ndryshëm si psh gjurmët e kafshëve, dhe është pa strukturë.

Tabela nr.3 Në tabelen me poshte jepen tipet kryesore te tokes dhe siperfaqja e tyre:

Shperndarja e tokave pyjore te komunes sipas tipeve **Tipi i tokes**	**Siperfaqja ha**
Tokat e kafenjta	458.20
Tokat e kafejta te kuqerremta	31.80
TOTALI	**490.00**

3.1.8. Hidrografia

Hidrologjia

Për shkak të relievit dhe formacionit amnor, territori i bashkisë ka një rrjet hirografik të varfër që përbëhet nga disa përrenj dhe proska që pjesën më të madhe të vitit janë të thatë dhe vetëm në stinën e dimrit dhe herët në pranverë ato janë me ujë. Ndër përrenjtë më të rëndësishëm janë përroi i Goricës së madhe dhe përroi i Lajthizës.

Burimet ujore

Burime ujore në kuptimin e vërtetë të fjalës mungojnë, çka përbën një shqetësim të madh për zonën për sigurimin edhe të ujit të pijshëm. Në gjithë territorin e zonës janë të njohur vetëm 2-3 burime uji si: Pusi i Hajdutëve në Malin e Thatë, lera e Cerckos (ish sektori i shfrytëzimit të pyjeve), burimi i Lajthizës dhe i Liqenasit. Të gjithë këto kanë rezerva shumë të vogla ujore të cilat në stinën e verës pothuajse shterojnë. I vetmi burim uji është liqeni.

Liqeni i Prespes është elementi më i rëndësishëm hidrografik të ketij territori duke përfshire dhe zonat fqinje të Maqedonisë së veriut dhe Greqisë.

3.1.9. Fenomeni i erozionit

Erozioni dhe masat për mbrojtjen e tokës

Mbrojtja e tokës (sidomos tokës bujqësore) nga degradimi i mëtejshem dhe erozioni e përdorimi racional i saj si pjesëpërbërëse e mbrojtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore në përgjithësi përbën një nga objektivat më të rëndësishme e të ndërlikuar për të ardhmen e banorëve të Bashkisë Pustec. Rëndësia e madhe dhe e veçantë e ndalimit të degradimit kushtëzohet nga fakti që rreth 98% e produkteve ushqimore të njeriut, përfshirë këtu edhe produktet blegtorale, sigurohen nëpërmjet përdorimit të tokës (Pyje, Kullotë, tokë bujqësore). Toka luan një rol shumë të madh ekologjik në jetën e të gjitha biogjeocenozave. Për këtë arsye mbrojtja e tokës nga erozioni e rrëshqitjet si dhe pasurimi i saj, mbetet objektiv i përhershëm i administratës së bashkisë dhe i banorëve të Pustecit.

Erozioni ka pakësuar lëndët organike humusore dhe ka ulur cilesitë fizike e kimike të saj, duke çuar në uljen e përgjithshëm të pjellorisë së tokës (bujqësore e pyjore) dhe prodhimtarisë së produkteve bujqësore si dhe ritmeve të rritjes vjetore të drurëve pyjore për njësi të sipërfaqes, që është kusht me rëndësi të jashtëzakonëshme për evitimin e erozionit dhe rritjen e pjellorisë së tokës.

3.2. Rrjeti rrugor

Rjeti rrugor mund të konsiderohet i kënaqeshëm pasi rruga nacionale Korcë-Liqenas-Doganë-Bitola(Manastir) e përshkon territorin e bashkisë në formë gjatësore, por edhe një sërë rrugësh dytësore lehtësojnë mundësinë e hyrjes në pyjet bashkiake. Cdo fshat i bashkisë është i lidhur me rrugë auto të asfaltuar

3.2.1. Përdorimi i territorit

Përdorimi i territorit në Bashkia Pustec është klasifikuar në:

-fond pyjor 31.80 ha

-bujqësore 1284 ha

-kullotë/livadh 458.20 ha

-djerrë/abandonuar 60 ha

Brënda fondit pyjor janë bërë disa ndarje:

-Sipas qeverisjes; .....31.80ha shkurre

-Sipas llojeve pyjore; .....0 ha

-Sipas ngastrave pyjore; ...1 ngastër

-Sipas funksioneve të pyllit; 31.8ha prodhues

Në rastin e ngastrave pyjore është ruajtur ndarja e bërë në planin e menaxhimit ekzistues. Por në këtë ngastër nga grupi i punës është bërë një punë shumë e hollësishme për të përcaktuar ndarjen në toka bujqësore, pyjore, kullosore apo përdorime të tjera të tokës.

3.2.2.Pyjet

3.2.2.1.Shkurret

Sipas të dhënave të inventarizimit në teritorin e PKPrespa hasen sipërfaqe të mbuluara meëshkurreku prej të cilave vetëm një parcelë me sip. 31.8ha I përket Bashkinë Pustec. Ato hasen kryesisht si formacione të përziera ku llojet kryesore janë shkoza e bardhë, dëllinja e kuqe, bulgeri, krekeza etj.

3.2.2.2.Cungishtet

Cungishtet I përkasin Parkut Kombëtar të Prespës. Ato përfaqësohen nga qarri, bunga, bungë buta, bulgeri, frashëri, panja, etj. dhe janë kryesisht grumbuj të rinj. Gjithashtu shumica e cungishteve janë të përziera, ku vihet re dhe përzierje me shkurret.

3.2.2.3.Trungishte

Pyjet e larte trungishte mungojne ne fondin e pyllit Bashkiak. Ato janë pjesë e zonës kryesore të parkut të Prespës dhe përbëhen nga llojet ah, lis, panjë, si dhe pyllëzime artificiale me pishë e zeze dhe bredhi.

3.2.3.Kullotat

Kullotat zënë një sipërfaqe prej 458.20 ha, të cilat janë sipërfaqe që I përkasin kullotave subalpine, ku pjesërisht bëjnë pjesë në zonën qëndrore të PKPrespa.

Nga forma e përdorimit ato nuk përdoren nga banorët vëndas për arsye të largësisë nga qëndrat e banuara dhe terenit të thyer malor.

3.2.4.Tokat djerrë

Tokat djerre përbëjne 84ha. Ato mund të takohen në fondin e tokave bujqësore, një pjesë të cilave për shkak të cilesisësë tyre të dobët dhe emigracionit nuk punohen. Planifikohet ndërtimi I lerave të ujit.

3.2.5.Pyllëzimet

Ne territorin e pyllit bashkiak pothuajse mungojne pyllezimet, pasi ato jane perqendruar ne zonen e pyjeve shteterore qe jane pjese e parkut. Janë planifikuar pyllëzime me farë në çeltira.

3.2.6. Vegjetacioni dhe biodiversiteti.

Periudha e vegjetacionit fillon me shkrirjen e dëborës zakonisht në fund të muajit Mars dhe në fillim të Prillit.
Me shkrirjen e borës bimët fillojnë të zhvillohen me vrull të madh dhe pejsazhi kodrinor dhe malor merr pamjen e tij shumëngjyrësh i cili bie në një kontrast te mahnitëshëm me ujrat e kaltra të liqenit të Prespës. Pas gjysmës së korrikut e gushtit, në vartësi të kundrejtimeve vërehet një qetësi e monotoni që karakterizohet nga zverdhja e lehtë e graminoreve, të cilët në shtator e ditët e para të tetorit i ndjek një blerim i lehtë. Kjo mbaron me ardhjen e brymës dhe ngricave të para duke ia lenë vendin gjumit deri në pranverën e vitit të ardhshëm.

Vëzhgimet në terren kishin si qëllim kryesor identifikimin e florës më të rëndësishme dhe elementet e vegjetacionit të sipërfaqes dhe karakterizimin e tipeve të ndryshme të vegjetacionit aktual i cili do të shërbejë si bazë në vendimet që do të merren për trajtimin e pyllit në të ardhmen.

Duke qënë pjesë e bimesise shqiptare ajo njëkohësisht për nga origjina, përberja dhe vecoritë gjeobotanike bën pjesë në nënzonën floristike mesdhetare.

Një pjesë e mirë e florës së bahkisë ka elemente të qartë të Evropës së mesme me përfaqesues si , frasheri, panja, shkoza.

3.2.7. Tipet aktuale të Pyjeve dhe potenciali natyror.

Tipet e vegjetacionit

Përshkrimi i tipeve të vegjetacionit që vijojnë është realizuar në bazë të shpërndarjes së tyre sipas gradienteve të lartësisë mbi nivelin e detit.

Pyjet e Bashkisë Pustec janë të larmishme përsa i perket llojeve dhe përfshihen në zonën fitoklimatike kastanetum. Krahasuar me të kaluarën ndryshimet e ndodhura vlerësohen si sasiore dhe cilësore. Kjo e lidhur me rritjen e popullsisë (disa herë më e madhe se në 1938) dhe me nivelin e ulët të intensifikimit të bujqësisë, apo e ushtrimit të aktiviteteve të tjera ekonomike.

3.2.8. Origjina e pyllit dhe natyraliteti.

Sipas prejardhjes, pylli i bashkisë Pustec është me prejardhje llastarore 31.80 ha. Përsa i përket natyralitetit pyjet janë gjysëm natyrale.

Mbi bazën e metodikës është bërë përshkrimi i natyralitetit në terren. Në përgjithësi kjo ngastër i është nënshtruar përdorimit nga njeriu si nga prerjet, kullotja, gjuetia, etj.

3.2.9. Biotopet e vecantë.

Biotopet

Pyjet e bashkisë Pustec kapin sipërfaqe shumë të vogël , megjithatë këtu takohen biotope me interes të veçantë si Dushku në kishën e Shulinit(MN), instaluar si rezultat të impaktit të mikroklimave dhe kushteve stacionale specifike që krijohen në zonën buzë liqenit.

3.3. Formacionet pyjore dhe bashkëshoqërimet

Formacionet me dushqe të perzierë shtrihen në pjesën më të madhe të sipërfaqes pyjore dhe I përkasin PKPrespa, duke u bashkëshoqëruar me lloje të tjera si panja, frashëri, lajthia, shkoza, venja, dëllenja e kuqe etj.

Dushkajat karakterizohen nga lloje të ndryshme dushqesh si qarri (Quercus cerris L,) Bunga (Quercus petraea Matt.Liebl), bung buta, bulgeri (q. Trojana) , që në mjaft raste perzien edhe me lloje të tjerë duke formuar pyje të përziera dushqesh të njohura me emrin quercetum mixtum. Përvec dushqeve rriten edhe drurë e shkurre të tjera. Nga llojet e shkurreve janë të pranishëm shkozë, dëllenja e kuqe, venjë etj, karakteristikë e të vetmes ngastër(134)që I përket bashkisë Pustec

3.3.1.Bimët endemike

Zona e Prespes është unike për dy lloje endemike që janë pjesë e vlerave të saj natyrore: Venja e cila gjendet si lloj i zakonshëm në siperfaqe të gjëra, pothuajse në të gjithë zonën, në përgjithësi e përzier me dushqet dhe dëllinjën e kuqe.

Lloji tjetër endemik është caraci i kaukazit, i cili ndodhet në një zonë të lokalizuar në një pjesë shkëmbore prani liqenit në afërsi të fshatit Gollomboc.

3.3.2. Llojet e rrezikuara

Në pyjet bashkiake duhet treguar një kujdes i veçantë për Venjën dhe endemizma të tjerë të zonës të cilat duhet të trajtohen me kujdes të vecantë.

3.3.3. Rezervat gjenetike

Nga të dhënat e mëparshme, por dhe nga vëzhgimet e realizuara në terren nuk parashikohet të ketë grumbuj pyjore që të jenë objekt studimi për rezerva gjenetike.

3.3.4. Zonat e mbrojtura

Sic u permënd më lart I gjithë territori i Bashkisë Pustec është pjesë e Parkut Kombëtar të Prespës i ndodhur në pjesën Jug-Lindore të Shqipërisë përbën një rast unikal në rrjetin e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë. Ky Park përfshin gjithë hapësirën shqiptare përreth liqeneve Prespë e Madhe dhe Prespë e Vogël dhe përbën nje vijim të Parkut Galicica në Maqedoninë e Veriut dhe Parkut Prespa në Greqi. duke shënuar një kontribut të vyer të Shqipërisë për mbrojtjen e rajonit në tërësi dhe duke shërbyer si një bërthamë e

të "Rezervës së Biosferës". Parku kombëtar i Prespës ka një sipërfaqe totale prej 27,613.05ha, që përfshin pyje dhe shkurre, kullota, livadhe natyrore dhe gjysëmnatyrore, sipërfaqe ujore si dhe toka bujqësore dhe zona-banimi. Parku kombëtar i Prespës është shpallur si i tillë me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. Nr. 80, datë 18.02.1999, rishikuar me vkm nr 59 dt26.01.2022.

3.3.5. Llojet kryesore të faunës së egër

Studimi dhe ruajtja e faunës është një nga elementet kryesore të biocenozës pyjore, i lidhur shumë ngushtë me ruajtjen e biotopit të saj, mjedisit pyjor. Për këtë arsye, ndërhyrjet e pakontrolluara vitet e shkuara kanë krijuar pasoja të rënda tek fauna dhe tek vlerat e biodiversitetit.

Për evidentimin e llojeve janë marrë në konsideratë vëzhgimet dhe të dhënat që dispojnë aktualisht AdZM Korçë dhe administrata e parkut Prespë, si dhe studime nga organizatat mjedisore që veprojnë në këtë zonë(PPNEA), qe disponojnë te dhëna dhe dinamikën për zhvillimin e faunës bazuar në monitorimet në teren dhe rezultatet e mara nga kamerat kurth në bashkëpunim me administratën e Parkut.
Për këtë arsye, paralelisht me opinionet private të dhëna në studime të ndryshme të vendit tonë i eshtë bërë referim edhe marrëveshjes së Bernës, e cila përkufizon speciet e egra që janë në mbrojtje strikte, apo thjesht që kanë nevojë për mbrojtje.

Shumica e faunës së egër tokësore formon komplekse faunistike karakteristike ose biocenoza. Biocenoza më tipike për zonën e Prespës është ajo e pyjeve të dushkut dhe ahut, që përbën kompleksin faunistik më të pasur me lloje kafshesh sidomos me gjitarë dhe shpendë. Fauna e kësaj zone jeton në kushtet e mbulesës pyjore të dëndur sidomos në pjesën e pyjeve shkurrore. Ndër llojet më prezente të këtij kompleksi faunistik janë ariu, ujku, rëqebulli I ballkanit(I rallë)dhelpra, derri i egër, lepuri, kaprolli, vjedulla, ketri, etj. Shpendët më karakteristike të ketij kompleksi janë pëllumbat e egër, thëlleza, grifsha, shqipja, mëllenjat, tushat e malit, qukapikët, gushkuqet, bilbilat, harabelat etj dhe shumë lloje të avifaunës ujore, ku pelikani kacurel është një specie e rezikuar globalisht.
Për të përcaktuar numurin e individëve dhe llojet, grupi i punës ka marrë informacioni nga administrata e zonave të mbrojtura, barinjtë, ku një dhënë e sigurtë janë regjistrimet e mara nga kamerat kurth dhe baza e të dhënave e mbajtur nga administrate e Zonave të mbrojtura.

Bazuar në studimet e mëparshme dhe nga krahasimi i të dhënave vihet re fakti i prezencës së kënaqëshme të gjitarëve dhe shpendëve tokësore. Përsa I përket shpendëve ujore, ku baza e të dhënave perditësohet çdo vit gjatë muajit janar referuar censusit dimëror të shpendëve të ujit, rezulton nje renie e nunmurit të shpëndëvë migratorë , por nje ritje e numurit te llojeve prezente në liqenin e Prespës. Ky fakt lidhet ngushtë me ngrohjen globale dhe është një fenomen që ndodh në të gjithë botën.

KAPITULLI IV
ANALIZA E PYLLIT

4. Prodhimet pyjore

Pylli bashkiak, ngastra nr 134, EP Liqenas me formë qeverimi Shkurre, ka funksion prodhues (dru zjarri) ne 31.80 ha. Kjo parcelë pavarësisht prodhimtarisë së ulet(ritja vjetore), ndodhet nën presionin e mbikullotjes, pasi ndodhet në afërsi të dy qendrave të banuara Pustec dhe Shulin, fshatra me një numur të konsiderueshëm të blegtorisë, po ashtu edhe prerjet abuzive të herëpsherëshme. Lëndë punimi nuk sigurohet nga pylli bashkiak.

4.1. Prodhimet drusore dhe cilesia

a- Drutë e zjarrit

Ndër prodhimet pyjore më kryesore janë prodhimi i druve të zjarrit, për nevojat e komunitetit. Pas shpalljes së PKPrespa procesi I sigurimit të nevojave të komunitetit për dru zjarri është I sigurtë dhe I mirëorganizuar. Plani I menaxhimit të PKPrespa 2014-2024 I ka përkushtuar një kapitull të veçantë plotësimit të nevojave të komunitetit me material djegës, dru zjarri. Për çdo vit ka qënë e planifikuar sasia e nevojshme e druve të zjarrit për cdo familje, fshat dhe bashki, përqindja e ndërhyrjes, ngastrat për çdo fshat dhe teknika e ndërhyrjes e pasqyruar në projektet teknike të hartuar nga Administrata e Zonave të mbrojtura.

□Lëndë ndërtimi

Pylli bashkiak nuk ka fuqi lëndore, pasi e vtmja parcelë që disponon bashkia Pustec është e përbërë nga shkurre. Lënda e ndërtimi për nevojat e fshatareve per ndërtim të ngrehinave/staneve për blegtorinë, mund të sigurohet nga pyjet e PKPrespa, ndërsa për ndërtim të shtëpive lënda e ndërtimit sigurohet në tregjet e lëndes drusore në zonat urbane.

□Prodhimi i hunjëve

Prodhohen kryesisht në pyjet e PKPrespa, për nevojat e vetë komunitetit rezident për ndërtimin e gardheve apo për kopshtet me perime.

□Prodhimi i gjethit

Prodhimi tradicional i gjethit në pyjet e lisit ka qënë një nga shqetësimet kryesore në këtë zonë. Zakonisht gjethi prodhohet me degë duke krasitur rreth 2/3 te kurorës të drurëve, në të shumtën e rasteve janë prerë dhe majat e drurëve, duke rezikuar të ardhmen e tyre. Gjethi transportohej në qendrat e banuara ose vihej mullar në pyll për ta përdorur si bazë ushqimore për blegtorinë për dimër. Me shpalljen e PKPrespa dhe me marjen e masave për plotësim të nevojave me dru zjarri, u ndje një rënie drastike të përdorimit të gjethit për dimër, pasi sigurohej nga degët që rezultonin nga prerjet legale të druve të zjarrit.

4.1.1 Prodhimet pyjore jo drusore, bimet mjeksore.

□ Prodhimet jo drusore

Krahas të tjerave në masivet pyjore dhe kullosore, por edhe në hapesirat midis tokave bujqësore të Bashkisë Pustec, rriten bimë drusore dhe barishtore me vlera mjekësore e tregëtare. Këto njihen mjaft mirë nga popullatat lokale dhe grumbullimi i tyre përbën nje aktivitet që ka ndikim në të ardhurat e komunitetit vëndas.Administrata e ZMM në bashkëpunim me Bashkine Pustec, ka tentuar me këmbëngulje kryerjen e studimeve të posaçme mbi përcaktimin e kapaciteteve të bimëve medicinale në Park dhe mundësine e vjeljes për cdo sezon dhe lloj. Kjo do të riste kujdesin për evitimin e vjeljes jashtë kapaciteteve të mundshme dhe njëkohësisht sigurimin e qëndrueshmërisë së prodhimeve vjetore.

4.1.2 . Funksionet kryesore

Pyjet/Kullotat bashkiake janë pjesë e klasifikimit të zonave në kuadrin e gjithë parkut të Prespës. Mbi këtë bazë përcaktohet kategoria e përdorimit të territorit bazuar në gjendjen aktuale edhe në klasifikim e mëposhtem. Pylli si ekosistem ka aftësinë të krijojë e të mbajë një mjedis natyror, të ushtrojë ndikime të ndryshme në mjedisin rrethues dhe të prodhojë biomasë. Grumbulli pyjor kryen shumë funksione por për efekt klasifikimi ato janë permbledhur :

a- Funksioni kryesor prodhues, këtu përfshihen pjesa më e madhe e grumbujve që kane drejtimin për dru zjarri e prodhim lëndës drusore.

b- Funksioni kryesor mbrojtes, këtu janë të grupuar ata grumbuj pyjor që shërbejnë për mbrojtje të tokës, për ujrat, klimen dhe infrastrukturën (rrugët, kanalet, banesat) etj. Bazuar në zonimin e parkut, pylli bashkiak bën pjesë në nënzonën e Përdorimit Tradicional dhe të Qëndrueshëm (ZPTQ)

4.1.3. Nënzonëa e Përdorimit Tradicional dhe të Qëndrueshëm (ZPTQ)

Përfshin zonat e banuara dhe zonat bujqësore si dhe gjithë zonat periferike pyjore që nuk bëjnë pjesë në Zonën Qëndrore(ZQ)

Nënzona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, me sipërfaqe 19558.03 (nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë presje zero tre) ha,

Kjo nënzonë përfshin tokat pyjore, bujqësore e kullotat, dhe territore ujore ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale si punime për shëndetësimin e pyjeve, aktivitete bujqësore, aktiviteti i peshkimit artizanal, kullotja, grumbullimi dhe kultivimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit natyror. Në nënzonën e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm, zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, që siguron një territor me ndikim të ulët dhe kontroll të veprimtarive ekonomike, sociale, agrobiznesit, argëtuese, sportive e ekoturistike, ndërtimi i infrastrukturës sipas planeve të zhvillimit urban e turistik të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), të cilat nuk cënojnë integritetin ekologjik të ekosistemit natyror dhe respektojnë funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike dhe ato të peizazhit natyror e kulturor.

Zonimi dhe sipërfaqet në Parkun Kombëtar "Prespa" jepen në Tabelën 2.

Tabela Nr 4. Zonimi i brendshëm i PK-së.

Zonimi	Sip. në ha	Përqindja
Zona qendrore	8055.02	29.17
Zona e përdorimit tradicional dhe zhvillimit të qëndrueshëm	19558.03	70.83
Totali	27613.05	100

4.1.4. Dëmtimet/rreziqet e shkaktuara nga zjarri, orteqet, insektet etj.

Gjendja fitosanitare.

Informacioni rreth gjëndjes shëndetësore nevojitet për të njohur pasojat e pyllit, vlerësuar rreziqet dhe nxjerrë masat për përmirësimin e situatës.

Gjendja e përgjithshme fitosanitare e grumbujve në përgjithësi është e kënaqshme, pra nuk kemi dëmtime të drurëve që çojnë në dëmtimin dhe zhdukje të tyre. Duke e përqëndruar vëmëndjen tek llojet kryesore dushqet dhe shkurret etj, themi se në këto lloje vërehen shënja të semundjeve dhe dëmtuesve, të cilat ndikojnë në ulje të rritjes dhe tharje të aparatit gjethor të drurit.

Dëmtime të tjera

Fondi pyjor me lloje të përziera fletorë, është një faktor objektiv që këto pyje jane pjesërisht të ekspozuara ndaj zjarrit pra ky ka qënë një problem jo shqetësues si në të kaluarën ashtu edhe tani. Fenomieni i zjarreve pothuajse mungon në pyjet/kullotat Bashkiake. Zjarret jane me shqetesues ne zonen parkut, sidomos ne zonen e kullotave alpine. Gjatë muajit gusht 2024, kullotat e PKPrespa, ek.kullosore "Mali I Thatë" u përfshinë nga një zjarr masiv I shfaqur në

kufirin Shqiptaro-Maqedonas V. Zjarri përshkoi dhe dogji nje siperfaqe prej rreth1000ha, kryesisht kullotë dhe rreth 100ha pyje dushku me përzjerje të dellinjës së kuqe në kufirin e sipërm të pyllit. Zjarri shkaktoi dëme të konsiderueshme duke djegur plotesisht shkurret në brëndësi të kullotave, kryesisht dëllinjën e zezë(*J.nana*), cajin e malit , pjesërisht salepin dhe shumë lloje të tjera bimësh medicinale, kullosore , bimë dhe shkurreta që I përkasin këtij habitati.

Kullotja e dhive në stinën e pranverës dëmton kurorat e drurëve të dushqeve duke u ushqyer me bisqe të njoma, këto shkaktojnë dëme pasi ulin prodhimtarinë e tyre.

Drurë të dëmtuar

Arsyet për tharjen e drurëve jepen duke shënuar shkaqet, si shpyllzimi, mbikullotja, zhvillim urban, zjarre, ndikime atmosferike, semundje/dëmtues, neglizhim në përkujdesje, kafshë të egra, shfrytezim, bora/akulli, era, të panjohura.

Ky tregues është vlerësuar në terren me vëzhgime gjatë punës për marrjen e sipërfaqeve provë dhe për pyllin bashkiak të marë në studim. Drurët janë të dëmtuar si shkak kryesor nga mbikullotja dhe prerjet pa kriter dhe shkaqet dytësore nga ndikime atmosferike dhe sëmundje e dëmtuesit.

Shkalla e dëmtimit

Shkalla e përhapjes së dëmtimeve të ndryshme ose numrin e drurëve të dëmtuar për tipin e demtimit kryesor dhe dytësor për drurët e pyjeve të këaj bashkie konsiderohen me intesitet të ulët.

4.1.5. Sistemet aktuale dhe të mëparshme të menaxhimit të pyjeve

Përcaktohen duke marrë në kosideratë dhe harmonizuar gjëndjen ekzistuese të pyllit, potencialin e stacionit, nevojat e përdoruesve si dhe metodat e menaxhimit.

4.1.6. Tipet e grumbullit.

Përcaktohet sipas përzjerjes së llojeve dhe shërben për analizimin e tyre, objektivave dhe masave konkrete. Studimi i Ngastrës pyjore(shkurre) është bërë në nivel parcele/nënparcele, ndarja e të cilave është bazuar në grupimin e drurëve me një strukture homogjene që zenë njësipërfaqe aq të gjëre sa që në brëndesi të këtij grupimi të quajtur grumbull të mos ndihet influenca e ambientit rrethues. Analiza është bërë nëpërmjet treguesve kryesore silvikulturale marrë gjatë grumbullimit të të dhënave për përshkrimin parcelar si dhe nga inventarizimi statistik me sipërfaqe prove të përherëshme dhe të përkohëshme.

Të dhënat e plota për parcelën 134 jepen në skedat e përshkrimit të grumbullit të ndarë në: të dhënat identifikuese, gjendja aktuale, objektivat e mbarështrimit, infrastruktura dhe masat. Në to paraqiten dhe të dhënat biometrike (karakteristikat dendrometrike) si lloji, sipërfaqja, trungdëndësia, kurorëdëndësia, dm, hm, mosha, rritjet dhe vëllimi për ha dhe ngastër.

Vëllimi është ndarë në asortimente lëndë punimi e trashë, e mesme, e hollë dhe dru zjarri. Për këtë janë përdorur tabelat e kubaturës të nxjerra nga IKPK.

a-Sipas përbërjes së llojeve

Të dhënat e përftuara nga inventarizimi kanë mundësuar që të përcaktohet për parcelën134 përbërja e llojeve. Në aspektin e përzierjes së llojeve janë konsideruar të thjeshtë grumbujt që me perjashtim të llojit kryesor mund të kenë lloje të tjerë pjesmarrja e të cilave është =/< 5 %. Më poshtë përshkruhen vetëm karakteristika kryesore të llojeve përbërës të grumbujve sepse në mënyrë të hollësishme treguesit silvikulturale dhe dendrometrikë të tyre jepen në kapitujt dhe tabelat përkatëse.

b-Sipas tipit struktural

Përbën një tregues të rëndësishëm për karakterizimin e grumbujve sipas kombinimit të drurëve me madhësi të ndryshme. Tipet strukturale jepen në vartësi të funksionit aktual dhe formës së qeverimit. Në parcelën e marë në studim kemi të bëjmë me formën e qeverimit shkurre.

Tipi struktural kopshtor dhe ai afersisht kopshtor në këtë parcelë nuk është i pranishëm.

c-Sipas formës së qeverimit

Karakterizimi i grumbujve sipas formës së qeverimit është bërë në funksion të raportit të formës së qeverimit të llojeve përbërës. Kur prezenca e nje forme qeverimi të llojit është në masën nën 10 % nuk është marrë në konsideratë.

Forma e qeverimit në këtë ekonomi rezulton të jetë forma e qeverimit shkurre, e cila ze 31.80 ha ose100% të sipërfaqes së grumbullit pyjor.

4.1.7. Metodologjia e vëzhgimeve biometrike

Metoda e vlerësimit: Duke qënë se ngastra nr 134 përbëhet nga shkurre, pra me diametra mesatar të vegjël, metoda kryesore e vlerësimit të të dhënave dentrometrike për llojet ka qënë ajo e vlerësimit me sipërfaqe të përkohëshme bazuar në vëzhgimet e parcelës duke e kombinuar me matje në siperfaqe prove të përkohëshme, për një vlerësim sa më të pranueshëm. Për rastet e grumbujve të përzier janë përdorur sipërfaqe prove të përkohëshme.

4.1.8. Ngastra dhe n/ngastra pyjore.

Përshkrimi parcelar ka për qëllim studimi në percaktimin e tyre në terren dhe karakterizimin e gjithë elementeve që mund të shërbejnë në njohjen e kushteve natyrore e të bimësisë, njohjen e karakteristikave të grumbullit aktual, përcaktimin e potencialit produktiv të stacionit, kapacitetin aktual të grumbujve, rregullimin e procesit të prodhimit pyjor etj.

Përshkrimi është bere në parcelën 134 dhe n/parcele shkurre, kullotë, sipërfaqe boshe. Nga karakteristikat që kanë rezultuar pas përpunimit të të dhënave janë bërë grupimet dhe klasifikimet në klasa moshe, janë nxierrë volumet dhe treguesit e tjere dendrometrikë. Në çdo fletë përshkrimi janë edhe masat e planifikuara që do të merren në përiudhen 3 dhe 10 vjeçare.

Përshkrimi parcelar është pjesë e ketij plani dhe i punuar në programin përkatës, për parcelën nr 134. Si skeda janë përdurur ato të paraqitura në Manualin e mbareshtrimit të pyjeve. Pamvaresisht nga relacioni përmbledhës i planit, përshkrimi parcelare ka një rëndësi të veçantë, pasi në mënyrë të detajuar karakterizohet gjëndja e parcelës. Pra gjatë zbatimit të këtij plani duhet ti referohemi vazhdimisht përshkrimit parcelar.

Elementet e përcaktuar pas 10 vjetësh do të krahasohen, nga ky krahasim mund të nxjerrim shumëkonkluzione për të ardhmen e kësaj ngastre dhe për efektivitetin e punimeve të zbatuara gjatë 10 vjecarit.

Kufijtë e parcelës 134, janë ruajtur ato të planit të vjetër të mbarështrimit me qëllim që të lehtësohet mbajtja e kadastrës pyjore. Në rastin e ndryshmeve brënda parcelës është bërë ndarja në nënparcela duke përdorur të njëjat kritere teknike sic përdoren në rastin e pyjeve shtetrore.

Parcelat dhe n/parcelat pyjore jane percaktuar duke u nisur nga udhëzuesi përkatës dhe në përgjithësi kufijtë e tyre janë lënë ato ekzistues sipas planit të mëparshëm. Sipërfaqa e ngastrës sic do jepet edhe në përshkrimin parcelar nuk ka pasur ndonjë ndryshim në sipërfaqe dhe mbetet ajo ekzistuesja e planit të vjetër të menaxhimit të vitit 2009.

Duke pasur parasyshe origjinen, prejardhjen e regjimin; fondi pyjor është ndarë në trungishte, cungishte e shkurre dhe sipërfaqe me tokë pyjore. Ngastra e marë në studim është me bimësi shkurorre.

Sipërfaqet prove të përherëshme u moren mbi bazën e ngastrave. Për ngastrën 134 u more siperfaqe prove shkurre 25m2, duke matur diametrin për çdo dru, lartësinë mesatare, cilësinë, nën pyllin dhe bimësinë barishtore, duke zbatuar të njëjtat procedura që përcaktohen në udhezuesin për mbarështrimin e pyjeve shtetrore. Të dhënat dentrometrike të këtyre sipërfaqeve prove janë baza për vlersimin e çdo percele që është klasifikuar në ate tip grumbulli.

4.1.9. Metodologjia e përdorur për grumbullimin e të dhënave në trungishte, cungishte dhe shkurre.

Metodologjia e përdorur për grumbullimin e të dhënave në trungishte, cungishte dhe shkurre është përdorur udhëzuesi i punimeve të terrenit dhe punimeve të zyrës

4.2. Specifikimet për sipërfaqet provë të përhershme të krijuara në nivel bashkie.

Këto sipërfaqe prove të përhereshme kanë si qëllim kryesor monitorimin e ecurise dhe zhvillimit të pyllit bashkiak duke bërë matje të përvitëshme dhe duke plotësuar formularët e iventarizimit sipas modelit të dhënë në aneksin përkatës.

4.2.1. Prodhimtaria, klasat e prodhimit

Prodhimtaria e grumbujve pyjore përcaktohet në bazë të klasifikimit të llojeve pyjore, moshës së tyre në pesë klasat e prodhimit sipas lartësisë mesatare që arrijne drurët. Nga sa më siper pylli bashkiak përbëhet nga shkurre.

4.2.2. Klasat e moshës

Gjatë përshkrimit parcelar për llojet kryesore të ngastrës 134 janë percaktuar mosha mesatare dhe janë bërë grupimet edhe sipas regjimit në klasa moshe dhe konkretisht:

-Shkurre me 6 klasa moshe ne interval, 5 vjecar **(Kl. VI – 31.80ha)**

4.2.3. Tipet strukturore dhe faza e zhvillimit

Si njësi bazë mbareshtrimi është përcktuar ngastra ose n/ngastra ku edhe të dhënat për strukturën janë përcaktuar duke marrë parasysh strukturën horizontale dhe atë vertikale.

a- Struktura horizontale

Eshtë percaktuar duke pasur parasyshe, perberjen, kuroredendesine, menyren e grupimit apo shperndarjen e tyre ne siperfaqe. Sipas ketyre treguesve jane percaktuar siperfaqet boshe, siperfaqet me ripertritje, imshtaje, pylli i rritur, pylli i pjekur, pylli i pjekur me ripertritje.

b- Struktura vertikale

Është përcaktuar duke ju referuar mënyrës së vendosjes së drurëve në kate, mënyres së mbylljes së profilit në planin vertical.

Fazat e zhvillimit: u përcaktuan duke përdorur klasifikimet përkatës dhe nga puna në terren rezultojnë të gjithë fazat e zhvillimit në parcelën pyjore bashkiake.

4.2.4. Llojet pyjore.

Sic është theksuar edhe në të dhënat e pëgjithëshme të bashkisë, fondi pyjor i kësaj Bashkie përbëhet vetëm nga nje parcel shkurre me sipërfaqe prej 31.80 ha.

Sic është përmëndur edhe më lart, flora pyjore është e përgjithësuar nga llojet natyrorë, të cilët gjënden në shkurret si shkoza, bulgeri venja, dellinja etj. Më poshtë po analizojmë gjëndjen fitosanitare të disa nga llojet kryesore.

Dushku (Quercus sp.) Ndër llojet kryesore të dushkajave është Bulgeri (Quercus trojana),, rallë Qarri (Quercus cerris etj

Treguesit dendrometrik në përgjithësi janë të ndryshëm dhe jepen në përshkrimin parcelar

Dushqet zakonisht takohen në formë të përzier midis tyre por edhe me llojet e tjera si frashër, krekëza sp. si dhe me shkurret si venja, dëllinja e kuqe dhe shkoza.

Venja: Eshtë lloji më i rëndësishëm dhe I rallë pasi ajo është specie endemike që jep vlera të vecanta zonës e shpallur Park Kombëtar.

Shkoza: eshte lloji i rëndësishëm në aspektin e përdorimit të saj për kullotje dhe prodhimin e druve të zjarrit. Në tërësi shkoza paraqitet shume e degraduar në formë kacube.

Dëllinja e kuqe; është lloji i tretë i shkurreve I cili haset në celtirat dhe I përzjerë me shkurre të tjerë përsa i përket sipërfaqes. Vlerat e saj qëndrojnë në prodhimin e frutave të cilat përdoren si bimë mjeksore. Shumë herë dëllinja përdoret nga banorët për prodhimin e hunjëve për gardhime pasi ai është nje dru i fortë.

4.2.5. Volumi dhe rritja

Rritja vjetore dhe volumi është përcaktuar me vlerësim në bazë të të dhënave të vëzhguara në terren

4.2.6. Prerja e lejuar vjetore, Mundësia vjetore e ndërhyrjes.

Bazuar ne gjendjen aktuale të parceles nuk bëhet fjale për prerje, por do të planifikohen masa për mbrojtjen nga kullota dhe prerjet abuzive si dhe krijimi I mundësive për pyllëzime në celtirat brenda dhe në periferi të parcelës.

4.2.7. Rigjenerimi natyral/artificial

Ripërtritja natyrore ose filizëria është një element i rëndësishëm në të ardhmen dhe vazhdimësinë e grumbullit pyjor. Ajo është një element esencial me anën e së cilës pylli ripërtrihet duke kaluar nga një brez tek një tjetër. Ne përgjithësi filizat e rinj vijnë nga cungu i cili pritet për dru zjarri ose krasitje dhe mungon interesi për filizat që mund te vijne nga mbirja e lendeve si element shumë i rëndësishëm për të ardhmen e pyllit. Synimi është që me planifikimet e bëra që në celtirat e kësaj ngastre shkurre përmes pyllëzimeve me farë dhe gërvishtje të jetnë mbyllur çeltirat në fund të 10 vjecarit, me përzjerjen llojore të lartpërmëndur duke përfshirë dhe llojet pyjorë frutorë. Ky do të jetë edhe objektivi kryesor i këtij projekti për ngastrën nr 134.

4.2.8. Ndryshimet nga plani i mëparshëm i menaxhimit.

Fondi pyjor që ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pustec është i zvogluar në 31.80 ha, I shtrirë në ekonominë pyjore "Liqenas". Për të bërë një krahasim apo vlerësim të grumbujve pas ndne fund te 10 vjecarit rhyrjeve apo masave tne fund te 10 vjecarit planifikuara mne fund te 10 vjecarit parne fund te 10 vjecarit , themi se masat e planifikuara nne fund te 10 vjecarit planet e mne fund te 10 vjecarit parshme nuk janne fund te 10 vjecarit zbatuar ose janne fund te 10 vjecarit zbatuar pjesne fund te 10 vjecarit rrisht.

4.2.9. Bimësia barishtore

Është nje element i rëndesishëm i pyllit, ku jeta dhe zhvillimi i tyre është i lidhur ngushtë. Prezenca dhe zhvillimi i një lloji të caktuar bimësie barishtore është një tregues dhe indikator për zhvillimin e bimësisë drunore dhe të pyllit në përgjithësi.

Në ngastrën nr 134 mbulesa me bimësi barishtore është mjaft e pakët..

KAPITULLI V

OBJEKTIVAT AFATGJATË DHE AFATSHKURTËR

5. Prodhimet pyjore

5.1. Prodhimet drusore lidhur me mundesine vjetore te ndërhyrjes

Në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me një sipërfaqe të vogël prej 31.8ha shkurre. Sigurimi I nevojave të komunitetit do të arihet vetëm nga pyjet e Zonave të mbrojtura brënda PKPrespa, si dhe përdorimi I alternativave të tjera për ngrohje.

Drute e zjarrit

Prodhimi pyjor kryesor janë drutë e zjarrit, nga vetë komuniteti I kësaj Bahkie, por që duhet të realizohet i kontrolluar dhe të prodhohet në parcelat shtetërore që menaxhohen nga AdZM Korçë. Parashikimi në Planin e ri të menaxhimit të PKPrespa I nderhyrjeve shëndetësuese dhe përdorimi I energjisë solare do të jetë zgjidhja e nevojave të komunitetit resident.

Lëndë ndërtimi

Për ndërtimet e banesave nuk ka kërkesa për lëndë ndërtimi pasi sigurohet nga tregu vëndas.

Prodhimi i hunjëve

Do të prodhohen kryesisht në pyjet e lisit që janë planifikuar ndërhyrje përmirësuese të planifikuara në Planin e menaxhimit të PKPrespa dhe materialet që rezultojnë, do të përdoret për nevoja të vetë fshatarësisë në ndërtimin e gardheve apo për kopshtet me perime.

5.1.1. Prodhimet pyjore jo drusore, bimët mjeksore.

Prodhimet jo drusore

Në bashkinë Pustec rriten bimë drusore dhe barishtore me vlera mjekësore e tregëtare. Këto njihen mjaft mirë nga popullatat lokale dhe grumbullimi i tyre përbën një aktivitet që ka ndikim në të ardhurat e komunitetit rezident. Ndër llojet më të rëndësishme dhe me vlera ekologjike dhe ekonomike janë: murrizi, trendafili i egër, dëllinja e kuqe dhe e zezë, lajthia, thana, kamomili, lulekuqja, mjedhra, bushi, molla e egër, kolumbria, zhumbrica, timusi, lule shëngjini, mullagat, netulla, tërfilat, hidhra, frasheri, etj.

Për të patur një rritje në sasi të tyre duhet që drurët dhe bimët që janë listuar në bimë me vlera mjeksore të mbrohen nga dëmtimet dhe të vilen në kohën dhe teknikën e duhur. Eshtë e domosdoshme ndërmarja e studimeve për përcaktimin e kapaciteteve të fondit të bimëve mjekësore dhe përcaktimi I zonave dhe munesisë së vjeljes në menyrë të organizuar.

5.1.2. Funksionet kryesore

Nevojat për mbrojtjen e natyrës, tokës, për ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e zonës në kuadrin e parkut kombëtar të Prespës kushtëzojne përcaktimin e funksioneve kryesore të propozuara të pyllit si funksion **mbrojtëjs me mundësi prodhimi(M me MP).**

5.1.3. Menaxhimi i rreziqeve

Masat për kufizimin e prerjeve të pakontrolluara; do te rritet kontrolli nga vetë bashkia shoqata në bashkëpunim me administratën e ZMM dhe të përmiresohet puna për ndërgjegjësimin dhe forcimin e bashkëpunimit me popullatat lokale.

Prerja vjetore nuk parashikohen për arsye të sipërfaqes së vogël dhe formës së qeverimit. Masat silvikulturale të propozuara kanë efekte pozitive mbi mjedisin. Ndërhyrjet parashikohen tëjenë të mbështetura në silvikulturën natyralistike. Pyjet me funksion mbrojtes dhe mundësi prodhimi të sipërfaqes pyjore do të krijojnë kushte për mbrojtjen me të mirë të tokës dhe biodiversitetit.

5.1.4. Sistemet e menxhimit të pyjeve

Per te patur nje sistem te sukseshem menaxhimi per kushtet aktuale te pyjeve dhe kullotave, potencialit te stacionit, nevojave te perdoruesve, po paraqesim te detajuar me poshte:

5.1.5. Tipet e pyllit

Nuk janë parashikuar ndryshime të detyruara të përberjes së llojeve, kjo për shkak se pylli I bashkisë Pustec, ndodhet në arealin e tij dhe nuk ka tendenca natyrore për zëvëndësimin e njeri tjetrit. Ndërhyrjet e propozuara nuk ndryshojnë tipin e pllit bashkiak, por do të rrisin sipërfaqet përkatëse të rahabilituara dhe do të ndryshojne përdorimin e territorit për sipërfaqn e vogël të pyllit Bashkiak.

5.1.6. Të dhënat biometrike (Vendosja dhe monitorimi i sipërfaqeve provë të përhershme)

Marrja e të dhënave biometrike për çdo n/parcelë do të shërbejnë jo vetem në vlerësimin e treguesve dentrometrik dhe përcaktimin e masave për përmirësimin e pyllit dhe kullotave, por dhe në marrjen e një informacion në cdo kohë lidhur me ecurinë e treguesve të zhvillimit të tij. Vendosja e sipërfaqeve provë të përhershme do të shërbejë në monitorimin e e objektivave të parashikuara në këtë plan menaxhimi.

5.1.7. Klasat e moshes

Pamvarsisht nga ndërhyrjet e planifikuar me përmirësim pyjesh, klasat e moshës për pyllin e bashkisë Pustec nuk do të kenë ndryshime esenciale.

5.1.8. Llojet Pyjore

Llojet pyjor kryesor që janë evidentuar gjatë punës në terren, do të jenë mbizotërues në pyllin e perzjerë ekzistues , por do të shtohen në sasi e në cilësi duke respektuar teknikat e ndërhyrjve përmirësuese dhe ndalimit të dëmtimit nga prerjet e pakontrolluara dhe kullotja. Në këtë drejtim një rëndësi të vecantë do ti kushtohet krijimit të kushteve sa më të favorëshme për venjën si lloj endemik me vlera prioritare sidomos në kuadrin e menaxhimit të Parkut kombetar Prespa.

5.1.9. Pyllëzimi/ripyllezimi , sistemimet malore ndërtim lerash.

Ndër masat për përmiresimin e situatës si në siperfaqet me bimësi të pakët pyjore dhe të eroduara, janë parashikuar punime ripyllëzime me lloje pyjorë me farë bulgeri, frashër, mollë e egër, goricë e egër, bajame e egër etj., ndërtim dhe meremetim lerash në tokat e abandonuara për tërheqjen e blegtorisë nga pasqyra e liqenit të Prespës.

Për cdo punim të parashikuar është hartuar miniprojekti dhe është marrë miratimi nga komuniteti përfitues, për punimin dhe llojin pyjore që do të mbillet duke garantuar mbrojtjen e tyre.

5.2. Qëndrueshmëria e mjedisit

Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave do të arrihet duke respektuar masat mbrojtese dhe silvikulturale të propozuara që nuk kanë efekte negative mbi mjedisin. Ndërhyrjet parashikohen të jenë të mbeshtetura në silvikulturën natyralistike. Ndryshimi i strukturës të pyllit të bashkisë Pustec, futja e koncepteve të reja të menaxhimit të zonës, bënë të domosdoshme hartimin e një Plani të ri të Menaxhimit, me qëllim mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe mjedisin.

KAPITULLI VI

PLANIFIKIMI I MASAVE

6. Pyllëzimet

Pyllëzimet janë planifikuar si punime, pasi ekziston nevoja për to kryesisht në çetirat, sipërfaqet e eroduara, pasi ekzistojnë të gjithë mundësitë që ripërteritja e pyllit të bëhet në rrugë artificiale dhe me kosto të ulet. Një vëmendje ju kushtua dhe mundësisë së pyllëzimit të tokave aluvionale të liruara nga tërheqja e liqenit të Prespës së Madhe, me lloje me ritje të shpejtë Plep dhe shelg.

.6.1. Pyllëzimet për sekuestrim karboni

Parcela pyjore bashkiake është e përshtatshme për nderhyrjet e projekteve me objektiv sekuestrimin e karbonit.

6.1.1. Masat në trungishte

Nuk parashikohet nderhyrje, pasi mungon forma e qeverimit trungishte. Trungishtet janë pjesë e zonës kryesore të parkut të Prespës.

6.1.2. Shfrytëzimet

Nuk parashikohet në zonat e mbrojtura.

6.1.3..Pyllëzime në shkurre dhe toka aluvionale

Tabela Nr 5. Shpërndarja e pyllëzimeve në teritorin e Bashkisë Pustec

Nr	Bashkia	Teritori I fshatit	Ekonomia Pyjore	Nr Ngastrës	Lloji I investimit	Njësia	Sasia
1	Pustec	Zaroshkë	Liqenas	59	Projekt pyllëzimi me fidane Plep I bardhë	Projekt	1
2	Pustec	Tuminec	Gorica-2	Bregu I liqenit Tuminec	Pyllëzimi me fidane Plep I bardhë	Projekt	1
3	Pustec	Pustec	Liqenas	134	Pyllëzimi me farë	Projekt	1

6.1.4. Masat në Cungishte/shkurre

Parcela 134 me formë qeverimi Shkurre, do të jetë objekt për tu shëndruar në pyll mbrojtes dhe rekreacion. Janë planifikuar pyllëzime me farë dushku, shkoze, mëlleze dhë frashër me përzjerje edhe të bajames së egër*(Prunus ëebi)dhe lloje të tjerë drufrutorë të pyllit si: mollë e egër(molus silvestris)Gorica e egër(Pyrus amigdaliformis)* dhe të tjera lloje autoktone (*Robinia Pseudoakacia)* etj.. Për sigurimin e ujit të pijshëm për blegtorinë dhe mënjanimin e saj nga përdorimi I ujit në brigjet e liqenit të Prespës parashikohet:

1.Ndërtimi i 2(dy)lerave të reja me hidroizolues dhe shtresë betoni në afërsi të ngastrës nr 134 (Pylli bashkiak Pustec), në tokat e abandonuara.

2. Meremetimi i 12 (dymbëdhjetë) lerave me hidroizolues dhe shtresë betoni në tokat e abandonuara prej të cilave, 1(nje) në teritorin e fshatit Cerje, 1(nje) ne teritorin e fshatit Zaroshke, 2(dy) ne teritorin e fshatit Lajthizë , 2(dy) në teritorin e fshatit Djellas(Shulin), 1(nje) në teritorin e fshatit Gollomboç, 1(nje) ne teritorin e fshatit Goricë eVogël. 2(dy) ne teritorin e fshatit Tuminec dhe 2(dy) ne teritorin e fshatit Goricë e Madhe.
3. Rikonstruksioni i 4(katër) lerave me plastmas dhe kalldrëm në tokat e abondonuara, ku prej të cilave 2(dy) në kullotat sub Alpine , 1(nje) në fshatin Pustec dhe 1(nje) ne teritorin e fshatit Goricë e Madhe

Tabela Nr 6. Shpërndarja e lerave në teritorin e Bashkisë Pustec

Nr	Bashkia	Teritori I fshatit	Lloji I investimit	Njësia	Sasia
1	Pustec	Pustec	Ndërtimi lere e re me hidroizolues dhe shtresë betoni	Copë	2

2	Pustec	Cerje	Merematim lere me hidroizolues dhe shtresë betoni	Copë	1
3	Pustec	Zaroshkë	Merematim lere me hidroizolues dhe shtresë betoni	Copë	1
4	Pustec	Lajthizë	Merematim lere me hidroizolues dhe shtresë betoni	Copë	2
5	Pustec	Shulin	Merematim lere me hidroizolues dhe shtresë betoni	Copë	2
6	Pustec	Gollomboç	Merematim lere me hidroizolues dhe shtresë betoni	Copë	1
7	Pustec	Goricë e Vogël	Merematim lere me hidroizolues dhe shtresë betoni	Copë	1
8	Pustec	Tuminec	Merematim lere me hidroizolues dhe shtresë betoni	Copë	2
9	Pustec	Goricë e Madhe	Merematim lere me hidroizolues dhe shtresë betoni	Copë	2
